



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 181/4 Prot.

Tiranë, më 12 . 05 .2025

VENDIM  
Nr. 87, datë 06.05.2025

PËR

**“PEZULLIMIN E PROCEDURËS DISIPLINORE SIPAS KËRKESËS NR. 1168/7  
PROT., DATË 25.04.2025, “PËR FILLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR NDAJ  
MAGJISTRATIT ELIO MAZREKU, ME DETYRË PROKUROR NË PROKURORINË  
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË”,  
TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), me pjesëmarrjen e:

|                          |                     |
|--------------------------|---------------------|
| 1. Zonjës Mirela BOGDANI | Kryetar             |
| 2. Zotit Erind GERMENJI  | Zv/Kryetar          |
| 3. Zotit Sokol STOJANI   | Anëtar              |
| 4. Zotit Zeqir HODA      | Anëtar              |
| 5. Zonjës Arta MANDRO    | Anëtar (në mungesë) |
| 6. Zonjës Ledina RIZA    | Anëtar (në mungesë) |
| 7. Zotit Moisi DUDA      | Anëtar              |
| 8. Zotit Vatë STAKA      | Anëtar              |
| 9. Zotit Olger EMINAJ    | Anëtar              |
| 10. Zotit Erind MERKURI  | Anëtar              |
| 11. Zotit Erion FEJZULLA | Anëtar(në mungesë)  |

në mbledhjen e datës 06.05.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 145, në lidhje me nenin 126, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 184, germa “e” dhe nenin 189, pika 1, germa “a” dhe pika 3 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe në nenin 66 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, shqyrtoi çështjen me objekt:

***“Për pezullimin e procedurës disiplinore sipas kërkesës nr. 1168/7 prot., datë 25.04.2025, “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Elio Mazreku, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë”,***



*të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:**

Pasi mori në shqyrtim, relacioni shoqërues nr. 181/3 prot., datë 30.04.2025, të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, dëgjoi relatorin zotin Erind Germenji, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

**V Ë R E N:**

1. Rezulton se, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (*në vijim Këshilli*) është depozituar shkresa nr. 1168/7 prot., datë 25.04.2025 “Kërkesë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj veprimtarisë së magjistratit Elio Mazreku, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, ardhur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë (*në vijim ILD*).
2. Kjo kërkesë është regjistruar me nr. 181/1 prot., datë 25.04.2025, në Këshill dhe shoqërohet nga vendimi nr. 1168/4 prot., datë 25.04.2025, “Për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Elio Mazreku, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, Raporti i hetimit disiplinor nr. 1168/3 prot., datë 24.04.2025, si dhe akte, shkresa dhe dokumente të mbledhura gjatë hetimit disiplinor.
3. Me vendimin nr. 1168/4 prot., datë 25.04.2025 “Për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Elio Mazreku, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, ILD ka vendosur:

*1. Përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratit Elio Mazreku, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, germa “ç”, “d”, “ë” dhe “g” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.*

*2. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Elio Mazreku, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, germa “ç”, “d”, “ë” dhe “g” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.*

*3. Propozimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, të parashikuar nga neni 111 i ligjit nr. 96/2016, për magjistratin Elio Mazreku, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, germa “ç”, “d”,*



*“ë” dhe “g” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.*

*4. Njoftimin e magjistratit Elio Mazreku me Raportin e Hetimit dhe me vendimmarrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi përfundimin e hetimit disiplinor për shkeljen disiplinore të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi.*

*5. Dërgimin e Raportit të Hetimit disiplinor së bashku me dosjen e hetimit disiplinor pranë institucionit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.*

*6. Njoftimin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë z. Arens Çela, në cilësinë e ankuesit, mbi përfundimin e hetimit disiplinor.*

4. Ndaj magjistratit Elio Mazreku ka një tjetër proces administrativ të filluar sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në përfundim të këtij procesi, me vendimin nr. 717, datë 23.11.2023, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur shkarkimin nga detyra të prokurorit Elio Mazreku. Ndaj këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit Elio Mazreku ka paraqitur ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, ku është regjistruar çështja (JR) nr. 5/2024, datë 07.02.2024.
5. Subjekti i rivlerësimit, magjistrati Elio Mazreku është njëkohësisht edhe subjekt i hetimit disiplinor sipas vendimit nr. 1168/4 prot., datë 25.04.2025, të ILD-së.
6. Për sa i takon qëndrimit që do të mbajë Këshilli lidhur me kërkesën e ILD për fillimin e procedimit disiplinor dhe marrjen e masës disiplinore ndaj magjistratit Elio Mazreku, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, germa “ç”, “d”, “ë” dhe “g” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, bazuar në ankesën e paraqitur nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Komisioni Disiplinor me shumicë votash të anëtarëve z. Zeqir Hoda dhe z. Erind Germenji, i propozoi Këshillit pezullimin e këtij procedimi deri në marrjen formë të prerë të vendimit të dhënë nga organi kompetent i rivlerësimit. Ndërsa, zoti Vatë Staka, i cili është edhe relator i çështjes, mban qëndrimin se kërkesa e ILD ka objekt të ndryshëm nga ai i KPA-së, pasi KPK ka vendosur shkarkimin e subjektit për kriterin e pasurisë dhe jo të profesionalizmit, dhe për këtë arsye, Këshilli duhet të vijojë me procedurën disiplinore ndaj magjistratit në fjalë.
7. Sa më sipër, lidhur me propozimin e ardhur nga Komisioni Disiplinor, Këshilli vlerëson si më poshtë vijon:
8. Në nenin 189, pika 3 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

*i ndryshuar, parashikohet se: “Këshilli i Lartë i Prokurorisë zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast apo situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj. ”*

9. Në aspektin e pezullimit të një procedure administrative individuale, Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 66 të tij, jep kuptimin e çështjes paraprake si parakusht për zgjidhjen e procedurës së filluar nga një organ publik. Sipas këtij neni: *“1. Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative, pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë...”*
10. Edhe në ligjin nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, trajtohet çështja e pezullimit të procedurës administrative, vetëm në aspektin e ndërvarësisë së procedimit disiplinor nga rezultatet e procedurave të filluara nga organe të tjera, pra në rastet e zhvillimit të një hetim penal ose të një procesi gjyqësor penal, administrativ, ose civil, ku është palë dhe magjistrati nën hetim ose procedim disiplinor dhe shkelja disiplinore e dyshuar ose e atribuar atij lidhet me të njëjtat fakte. Konkretisht, në nenin 145, të ligjit, titulluar *“Pezullimi i procedimit disiplinor”*, përcaktohet se: *“Parashikimet ligjore gjatë procedimit disiplinor të nenit 126, të këtij ligji, do të aplikohen për aq sa gjejnë zbatim”*.
11. Nga ana tjetër, në nenin 126, të këtij ligji, titulluar *“Pezullimi i hetimeve”*, parashikohet se: *“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil: a) në të cilat, njëra nga palët është magjistrati; b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi. 2. Hetimi pezullohet deri në dhënien e vendimit të formës së prerë të institucionit kompetent. ....*  
*6. Vendimi për pezullimin e hetimit nuk ankimohehet”*.
12. Neni 179/b, pika 7, e Kushtetutës ka parashikuar se: *“7. Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë...”*
13. Më tej, neni 164, i ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, përcakton se: *“1. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse: ...b) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*.
14. Referuar të dhënave të faktit, magjistrati Elio Mazreku rezulton që, në të njëjtën kohë, të jetë subjekt i dy proceseve, ku ai i filluar më herët (procesi i rivlerësimit kalimtar) ka



përfunduar dhe organi kompetent disiplinor ka marrë masën “Shkarkim nga detyra”, vendim ky që aktualisht është objekt i kontrollit nga organi më i lartë i rivlerësimit.

15. Ndërkohë, procesi tjetër, procedimi disiplinor ndaj magjistratit Elio Mazreku (sipas përcaktimeve të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar) është aktualisht për shqyrtim përpara organit të përhershëm disiplinor të prokurorëve, pra, Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

16. Çështja që shtrohet për diskutim në këtë rast është:

- A mund të vijojë shqyrtimi i procedimit të dytë disiplinor ndaj magjistratit, z. Elio Mazreku, nëpërmjet të cilit, nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë synohet dhënia e masës disiplinore “Shkarkimi nga detyra”, sa kohë kur për magjistratin, në procedimin e parë disiplinor në kohë, tashmë është dhënë masa disiplinore “Shkarkim nga detyra”? Thënë ndryshe, a mund të vijojë Këshilli i Lartë i Prokurorisë shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit dhe, në hipotezë, të synohet dhënia e një mase disiplinore ndërkohë që, në procedimin e parë disiplinor, ndaj tij është dhënë masa disiplinore “Shkarkim nga detyra” nga një tjetër institucion kompetent?

17. Për zgjidhjen e kësaj dileme juridike, Këshilli mban në konsideratë parashikimet ligjore në fuqi, sipas të cilave, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për “Shkarkim nga detyra” të magjistratit, përbën në vetvete një masë disiplinore, që përcaktohet shprehimisht në nenin 58, pika 1, germa “c” (Masat disiplinore)<sup>1</sup>, sikundër edhe në nenin 61 (Shkarkimi nga detyra)<sup>2</sup> të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

18. Vendimi i këtyre organeve kushtetuese për dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, është një vendim, pasojat juridike e të cilave fillojnë menjëherë dhe përbëjnë shkak për ndërprerjen e menjëhershme të ushtrimit të detyrës nga prokurori subjekt rivlerësimi, ndaj të cilit ai është marrë<sup>3</sup>.

19. Në përputhje me pikën 6, të Nenit F, të Aneksit “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, të Kushtetutës, kur ushtron ankim kundër masës disiplinore të shkarkimit nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, subjekti i rivlerësimit pezullohet nga detyra deri në marrjen e vendimit nga Kolegji i Posaçëm të Apelit.<sup>4</sup> Për rrjedhojë, aktualisht, prokurori Elio Mazreku rezulton i pezulluar nga detyra.

<sup>1</sup> “1. Në përfundim të procesit, Komisioni mund të vendosë për subjektet e rivlerësimit: ...; c) shkarkimin nga detyra...”

<sup>2</sup> “Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: ...”.

<sup>3</sup> Neni 62, i ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se: “1. Subjekti i rivlerësimit, i cili ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit për masë disiplinore për shkarkimin nga detyra, pezullohet ex lege nga detyra e tij në pritje të vendimit të Kolegjit të Apeliteve. Gjatë periudhës së pezullimit atij i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj, në përputhje me nenin F, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës. 2. Në këtë rast, subjekti i rivlerësimit nuk ka të drejtë të shqyrtojë dhe të gjykojë çështje....”

<sup>4</sup> <https://kpa.al/wp-content/uploads/2018/04/Aneksi-Kushtetues.pdf>



20. Nga ana tjetër, ligji nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, kalimin me sukses të procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, e konsideron si parakusht për vijimin e gëzimit nga prokurorët në detyrë, të statusit të magjistratit, të parashikuar në këtë ligj.
21. Në rastin konkret, ky proces, i natyrës disiplinore për magjistratin Elio Mazreku, aktualisht ka përfunduar përpara me vendimin nr. 717, datë 23.11.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si organi disiplinor kompetent për kontrollin e ligjshmërisë së pasurisë, të pastërtisë së figurës dhe të pasjes së aftësive minimale profesionale për periudhën e rivlerësimit, sipas pikës 5, neni 179/b, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, i cili ka vendosur marrjen e masës disiplinore *“Shkarkim nga detyra”*, masë e cila sipas ligjit krijon si efekt të menjëhershëm pezullimin nga detyra të magjistratit deri në përfundim të shqyrtimit të çështjes së rivlerësimit nga organi kontrollues, Kolegji i Posaçëm i Apelit si Dhoma e Dytë e Gjykatës Kushtetuese, në rast të ankimit, rrethanë kjo që është vërtetuar në rastin konkret, pasi zoti Elio Mazreku ka paraqitur ankim kundër vendimit të dhënë ndaj tij si subjekt rivlerësimi.
22. Fakti që propozimi i masës disiplinore *“Shkarkim nga detyra”*, nuk është shqyrtuar ende nga Këshilli, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, nuk mund të çojë në mos ekzistencën e kësaj mase disiplinore dhe as në anashkalimin e saj.
23. Me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi, Kushtetuta, me ndryshimet e vitit 2016, parashikoi ngritjen e sistemit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, një proces ky i jashtëzakonshëm dhe tranzitor, që kryhet nga organet e pavarura kushtetuese dhe që ka për qëllim kontrollin e ligjshmërisë së pasurisë, të pastërtisë së figurës dhe të pasjes së aftësive minimale profesionale. Në kuadër të këtij procesi ligjor, Kushtetuta dhe ligji i dalë në zbatim të saj (ligji nr. 84/2016), kanë konsideruar që, në raport me objektin e rivlerësimit kalimtar, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit vepron si organ disiplinor ndaj prokurorëve dhe gjyqtarëve.
24. Nisur nga kjo, vendimmarrja e këtij organi disiplinor, i dhënë brenda kompetencave të tij, nuk mund të anashkalohet dhe të mos merret në konsideratë nga Këshilli. Në vendimin nr.2, datë 18.01.2017, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: *“22. I gjithë procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si pjesë e paketës së reformës në drejtësi, edhe pse është një masë e jashtëzakonshme dhe me karakter të përkohshëm, është ngritur nga kushtetutëbërësi në rang kushtetues, duke parashikuar institucionet që do të kryejnë këtë proces, kompetencat e tyre, si edhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve dhe garancitë që ata gëzojnë. Qëllimi i përcaktimit të kompetencave të këtyre organeve në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kushtetutë do të thotë se asnjë institucion nuk mund të marrë këto kompetenca apo t'i anashkalojë ato”*. Nga ana tjetër, në hipotezën që vendimi i Komisionit

të Pavarur të Kualifikimit lihet në fuqi nga organi më i lartë kontrollues, kjo masë disiplinore sjell si pasojë mbarimin e statusit të magjistratit për zotit Elio Mazreku.

25. Ligjërisht, procesi i rivlerësimit kalimtar dhe procedimi disiplinor sipas nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, janë dy procese të pavarura nga njëri tjetri, që zhvillohen nga organe të ndryshme, të pavarura dhe sipas procedurave jo të njëjta, rrethana këto që, pavarësisht faktit që ato zhvillohen ndaj të njëjtit magjistrat, bëjnë të pamundur bashkimin e tyre në një procedim të vetëm. Ndërkohë, këto procese kanë ndikim ndaj njëri-tjetrit, duke përcaktuar vijueshmërinë e tyre. Kështu, procesi i rivlerësimit, që është një proces i detyrueshëm për të gjithë prokurorët në detyrë (në momentin e miratimit të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016), përcakton vijimin e gëzimit nga ata të statusit të magjistratit sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga ana tjetër, moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit passjell mbarimin e menjëhershëm të statusit të magjistratit, rrethanë kjo që përbën shkak për mbylljen e procedimit disiplinor sipas këtij ligji, referuar nenit 139, pika 1, shkronja “c”<sup>5</sup>, në lidhje me nenin 134, pika 1, shkronja “ç”<sup>6</sup>, nenin 64, pika 1, shkronja “ç”<sup>7</sup> dhe nenin 164, të tij.
26. Vlen të theksohet se masa disiplinore “Shkarkim nga detyra” sipas përcaktimeve të ligjit për rivlerësimin kalimtar, pra mbi bazën e një ligji me natyrë kalimtare, nuk mund të sanksionohet nga ligjvënësi si një mënyrë e mbarimit të statusit në dispozitat e nenit 64, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, por vetëm në dispozitat kalimtare të tij. Konkretisht, është neni 164, të këtij ligji, i cili vendos një urë lidhëse midis dy ligjeve, duke zgjeruar interpretimin e shkronjës “ç”, të pikës 1, të nenit 64, dhe duke sanksionuar se statusi i magjistratit mbaron edhe në rastet kur ai shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në interpretim të kësaj dispozite ligjore arrihet në përfundimin se, ligji për rivlerësimin kalimtar, për aq kohë sa është duke u zbatuar dhe është në fuqi, dikton rrethin e subjekteve që gëzojnë statusin e magjistratit dhe ndaj të cilëve zbatohen dispozitat ligjore të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe si rrjedhojë dhe të dispozitave që rregullojnë përgjegjësinë e tyre disiplinore.
27. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ka rregulluar edhe pezullimin e procedimit disiplinor në nenin 145, dispozitë

<sup>5</sup> 1. Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse: ..... c) ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”.

<sup>6</sup> 1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se: ... ç) magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të këtij ligji .....

<sup>7</sup> 1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: ..... ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji;....



kjo që referon në nenin 126 të tij, që bën fjalë për pezullimin e hetimit disiplinor. Në rastin konkret, jemi para një procesi administrativ (procesi i rivlerësimit kalimtar) që zhvillohet ndaj magjistratit Elio Mazreku, objekti i të cilit është pikërisht verifikimi i kërkesave kushtetuese për vijimin e mbajtjes prej tij të statusit të magjistratit.

28. Procesi i rivlerësimit kalimtar, si një masë e jashtëzakonshme dhe me karakter të përkohshëm, e ngritur nga kushtetutëbërësi në rang kushtetues, nuk është pjesë e rregullimeve të përhershme ligjore në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, lidhur me përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve, kjo në mënyrë të vetëkuptueshme për shkak të përkohshmërisë së zbatimit të tyre.
29. Nga ana tjetër, po ashtu, siç mund të konstatohet, dualiteti i mundshëm i procedimeve disiplinore ndaj magjistratëve për periudhën e përkohshme nuk ka gjetur trajtim, përmes ndonjë rregullimi specifik, as në dispozitat tranzitore të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (përveç sa parashikohet në nenin 164 të tij).
30. Ndërkohë, në kuptim dhe zbatim të këtij ligji, magjistrati nuk mund të jetë në të njëjtën kohë nën disa hetime ose procedime disiplinore të veçanta, kjo për shkak të ndikimit që ato kanë lidhur me sanksionin disiplinor sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 115 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Kështu, në rastin kur magjistrati është nën hetim disiplinor, ndërsa ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër disiplinore, atëherë objekti i hetimit disiplinor duhet të shtohet ose ndryshohet<sup>8</sup> ose procedimet hetimore duhet të bashkohen kur ato iu referohen të njëjtave fakte<sup>9</sup>. Po ashtu, edhe në rastin kur magjistrati është nën procedim disiplinor, ndërsa ngrihen dyshime të arsyeshme se mund të jetë kryer një shkelje tjetër disiplinore, atëherë procedimi disiplinor ndërpritet dhe çështja i kalon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për kryerjen e hetimeve të mëtejshme dhe, në eventualitet, mund të shtohet ose ndryshohet objekti i procedimit disiplinor, si dhe, nëse është rasti i panevojshmërisë së hetimeve të mëtejshme, procedimi disiplinor vazhdon duke u shtuar ose ndryshuar objekti i tij<sup>10</sup>. Dhe po ashtu, kur magjistrati gjendet nën disa procedime

<sup>8</sup> Neni 125 i Ligjit për Statusin, titulluar “Shtimi ose ndryshimi i objektit të hetimit”, parashikon se: “1. Në rast se gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit, në zbatim të nenit 124 të këtij ligji. 2. Rregullat e parashikuara në pikat 2 deri në 4, të nenit 123, të këtij ligji, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim”.

<sup>9</sup> Neni 128 i Ligjit për Statusin, titulluar “Bashkimi i procedimeve hetimore”, parashikon se: “Inspektori i Lartë i Drejtësisë bashkon procedimet, në rastet kur konstaton se ankesat ose hetimet e filluara u referohen të njëjtave fakte ose të njëjtit magjistrat”.

<sup>10</sup> Neni 136 i Ligjit për Statusin, titulluar “Dërgimi i çështjes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, parashikon se: “1. Nëse gjatë procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson se ka dyshime të arsyeshme që mund të jetë kryer një shkelje tjetër, atëherë: a) kërkon të ndërpresë procedimin disiplinor, vendos për shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, kryen hetimin e nevojshëm dhe paraqet raportin e hetimit të mëtejshëm brenda një muaji nga ndërprerja e procedimit; b) i kërkon Këshillit që të shtojë ose ndryshojë objektin e hetimit, nëse nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme, pasi të ketë marrë mendimin e palëve. 2. Këshilli mund të dërgojë çështjen te Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në rastet e parashikuara në nenin 144 të këtij ligji”;

disiplinore që iu referohen të njëjtave fakte, procedimet bashkohen<sup>11</sup>. Pra, ligji bazë për përgjegjësinë disiplinore të magjistratit, tek i cili mbështet qëndrimin e tij dhe ILD lidhur me pamundësinë e pezullimit të procedimit disiplinor, nuk pranon ekzistencën në të njëjtën kohë të disa procedimeve disiplinore ndaj një magjistrati. Ndaj, për zbatimin strikt të këtij ligji (ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar*), do të duhej që të gjitha faktet e atribuara si shkelje disiplinore magjistratit në fjalë, të shqyrtoheshin në një procedim disiplinor të vetëm.

31. Por një gjë e tillë, sikurse më lart u përmend, është e pamundur ligjërish pas, sipas legjislacionit në fuqi, procesi i rivlerësimit kalimtar dhe procedimi disiplinor sipas ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, janë dy procese të pavarura nga njëri tjetri, që zhvillohen nga organe të ndryshme, të pavarura dhe sipas procedurave jo të njëjta.
32. Në këto kushte, Këshilli vlerëson se, zbatimi i legjislacionit në fuqi për përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve kërkon, nga njëra anë, pranimin e realiteteve kushtetuese, ligjore dhe faktike dhe, nga ana tjetër, adresimin e tyre në mënyrë efektive dhe efikase për qëllimin e zbatimit të saj, pikërisht zbatimin kur është rasti të sanksioneve disiplinore me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë së magjistratit në ushtrimin e funksionit në të ardhmen.
33. Në këtë kuptim, Këshilli sjell në vëmendje, se qëllimi i nenit 126, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar*, është dhënia përparësi e proceseve të tjera ligjore ndaj magjistratit në raport me procedimin disiplinor, duke kushtëzuar këtë të fundit me përfundimet e tyre, sa kohë ato kanë lidhje dhe ndikim të drejtpërdrejtë në këtë të fundit. Dhe në rastin konkret është e dukshme se mënyra e përfundimit të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj zotit Elio Mazreku, ka ndikim të drejtpërdrejtë dhe kushtëzon vijimin e procedimit disiplinor ndaj tij, në harmoni dhe me përcaktimin e nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative, Kod i cili është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga Këshilli (neni 189, pika 3, i ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar*), duke përligjur pezullimin e këtij procedimi disiplinor.
34. Nga informacioni i administruar për këtë çështje, rezulton se aktualisht është vënë në diskutim dhe është pranuar ekzistenca e një shkaku kushtetues për mbarimin e statusit të magjistratit Elio Mazreku, në kushtet kur është *“Shkarkuar nga detyra”* nga organi

si dhe neni 144, i këtij ligji, titulluar *“Ndryshimi ose shtimi i objektit të procedimit disiplinor”*, parashikon se: *“1. Kur Këshilli çmon se çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit magjistrat, ka të drejtë: a) të urdhërojë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor, në përputhje me këtë ligj, si dhe të hetojë këto pretendime të tjera të paktën brenda afatit njëmuor; b) të vendosë mbi pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, nëse nuk është i nevojshëm hetim i mëtejshëm, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim. 2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vepron sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 136, të këtij ligji”*.

<sup>11</sup> Neni 140 i Ligjit për Statusin, titulluar *“Bashkimi i procedimeve disiplinore”*, parashikon se: *“1. Kur Këshilli konstaton që procedimi disiplinor u referohet të njëjtave fakte dhe të njëjtit magjistrat, mund të vendosë bashkimin e procedimeve. ...”*.

disiplinor i rivlerësimit kalimtar dhe çështja e rivlerësimit ndodhet për shqyrtim përpara organit më të lartë të rivlerësimit. Në këto kushte, Këshilli vlerëson se një rrethanë e tillë përbën shkak që, bazuar në nenin 145 të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar*” dhe nenin 66 të Kodit të Procedurave Administrative, të vendoset pezullimi i shqyrtimit të procedimit disiplinor i filluar nga ILD, deri në përfundim të çështjes së rivlerësimit përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pasi mbajta ose jo e statusit të magjistratit nga Z. Elio Mazreku, në kuptim të ligjit nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar*”, përbën parakusht për shqyrtimin në themel të procedimit disiplinor ndaj tij, në kushtet kur shkarkimi nga detyra e magjistratit, sikurse më lart u parashtrua, përbën një nga rastet e mbylljes së procedimit disiplinor.

35. Nga ana tjetër, në eventualitetin e marrjes nga Kolegji i Posaçëm i Apelit të një vendimi për prishjen e vendimit të shkarkimit nga detyra të magjistratit, ekzistojnë kushtet ligjore për rënien e shkakut të pezullimit të procedurës së shqyrtimit disiplinor dhe rifillimin e tij.
36. Këshilli thekson se, pikërisht pezullimi i procedimit disiplinor siç paraqitet në rastin konkret nuk pengon shqyrtimin e tij në një kohë të mëvonshme (me rënien e shkakut të pezullimit), nëse nuk do të verifikohet rasti i mbylljes së tij (mbarimi i statusit të magjistratit për zotin Elio Mazreku për shkak të *“shkarkimit nga detyra”* me vendim përfundimtar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar). Pra, ky pezullim nuk sjell asnjë pasojë negative për procedimin disiplinor dhe as pengon shqyrtimin e tij nëse plotësohet kërkesa e ligjit, pikërisht qartësimi i rrethanës së vijimit të mbajtjes nga prokurori i proceduar nga ana disiplinore, të statusit të magjistratit.
37. Ndërkohë, referuar pikës 6, të nenit 126, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“6. Vendimi për pezullimin e hetimit nuk ankimohet”*, në lidhje me përcaktimin e nenit 145, të këtij ligji, sipas të cilit parashikimet e nenit 126, aplikohen për atë që gjejmë zbatim edhe për procedimet disiplinore, Këshilli vëren se, ligji iu ka kufizuar subjekteve të procedimit disiplinor të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj vendimit të pezullimit të procedimit disiplinor, pra ndaj këtij vendimi nuk lejohet ankimi.
38. Në përfundim, pasi analizoi kërkesën e paraqitur nga ILD për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Elio Mazreku dhe dhënien ndaj tij të masës disiplinore *“Shkarkim nga detyra”*, si dhe relacionin e përgatitur nga Komisioni Disiplinor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me 5 (pesë) vota pro dhe 3 (tre) kundër, vlerësoi se procedimi disiplinor ndaj këtij magjistrati duhet të pezullohet deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

**PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 149, pika 1 dhe nenin 149/a, pika 1, germa "b", të Kushtetutës, nenin 184, germa "e" dhe nenin 189, pika 1, germa "a" dhe pika 3 të ligjit nr. 115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*" i ndryshuar, në nenin 145 dhe nenin 126 të ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, dhe nenin 66 të Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Pezullimin e procedimit disiplinor Nr. 1168/7 prot., datë 25.04.2025, të filluar me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj magjistratit Elio Mazreku, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Ky pezullim ka efekt deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit Elio Mazreku, me vendim përfundimtar.
3. Ky vendim i njoftohet brenda 5 (pesë) ditëve magjistratit Elio Mazreku dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 06.05.2025.



**KRYETAR**  
Mirela Bogdani  
(kundër)

**ANËTAR**  
Sokol Stojani

**ANËTAR**  
Vatë Staka  
(kundër)

**ANËTAR**  
Zeqir Hoda

**ANËTAR**  
Olger Eminaj

**ZV/KRYETAR**  
Erind Germenji

**ANËTAR**  
Moisi Duda

**ANËTAR**  
Erind Merkuri  
(kundër)

## MENDIM PAKICE

1. Ne, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Mirela Bogdani, Vatë Staka dhe Erind Merkuri, duke qenë se nuk ndajmë të njëjtin qendrim me shumicën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që ka vendosur *“Pezullimin e procedimit disiplinor Nr. 1168/7 prot., datë 25.04.2025, të filluar me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj magjistratit Elio Mazreku, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”*, e çmojmë të nevojshme të paraqesim arsyet se përse e konsiderojmë jo të drejtë këtë vendimmarrje.
2. Kushtetuta, ligji themelor i vendit, që përcakton organizimin dhe funksionimin e institucioneve kushtetutuese, në nenin 147/d, pika 1 parashikon se: *“Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj”*. Më tej, po ky ligj themelor, në nenin 149, pika 1, parashikon se: *“Këshilli i Lartë i Prokurorisë garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”*.
3. Siç mund të konstatohet, Kushtetuta, ka pajisur me kompetenca në fushën disiplinore, përse i përket prokurorëve, dy institucione dhe konkretisht Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, që realizon hetimin disiplinor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, që gjykon mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga ILD-ja.
4. Këto parashikime kushtetuese, nuk janë kompetenca diskrecionare që varen nga vullneti i këtyre organeve për t'i ushtruar ose jo. Përkundrazi, ushtrimi i tyre është detyrim kushtetues dhe çdo shmangie e tyre përbën cënim të ligjit themelor të vendit.
5. Ky qendrim mbështetet edhe në Kodin e Procedurave Administrative, i cili në nenin 22, pika 2 të tij, parashikon se: *“Kompetencat e organeve publike janë të përcaktuara me ligj, me akt nënligjor, si dhe veprimet administrative të nxjerra në zbatim të tyre. Ushtrimi i tyre është i detyrueshëm”*.
6. Referuar fakteve të kësaj çështjeje, rezulton situata jo normale, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka ushtruar kompetencën e tij kushtetuese dhe nuk i është shmangur përgjegjësisë së tij, kurse Këshilli vendosi që të mos e ushtrojë detyrën e tij kushtetuese duke iu shmangur përgjegjësisë që ka si institucion.
7. Argumentimi që shumica kërkon të bëjë nisur nga fakti që për këtë prokuror është marrë masa e shkarkimit nga detyra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendim ndaj të cilit vetë ky subjekt ka ushtruar ankim që pritet të shqyrtohet nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, nuk është bindës dhe për ne, mbetet një justifikim pa bazë ligjore për arsyet që do të japim në vijim.

8. Kështu, shumica e nis arsyetimin e saj duke u cituar ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, nenin 189, pika 3, që tekstualisht parashikon se: "Këshilli i Lartë i Prokurorisë zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast apo situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj". Siç rezultojnë nga ky parashikim ligjor, dhe nga mënyra e vendosjes së tij, që në fillim të argumentave që jep shumica, tregon që Këshilli ka vendosur të referohet kryesisht në Kodin e Procedurave Administrative dhe konkretisht nenin 66 të tij, që parashikon mundësinë e marrjes së një vendimi të ndërmjetëm për pezullimin e një procedure administrative, kur ajo lidhet me procedime apo gjykime të tjera civile, penale dhe administrative.

9. Ne, si anëtarë në pakicë, jemi të mendimit, që referimi në këtë dispozitë dhe më pas në Kodin e Procedurave Administrative është haptazi i pabazuar në këtë rast, pasi duhet theksuar se rastet e pezullimit të një procedimi idisplinor janë rregulluar nga ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" i ndryshuar, nenet 126 dhe 145 të tij.

10. Pikërisht qasja që bën, shumica duke e nisur arsyetimin e saj jo me këto norma konkrete, por me parashikime të tjera me natyrë të përgjithshme, cenon strukturën e legjislacionit që rregullon procedimin disiplinor, rregullat e interpretimit dhe jurisprudencën kushtetuese.

11. Më konkretisht Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 2, datë 3.2.2010, ndër të tjera, ka arsyetuar se: "Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër (*lex superior derogat inferiori*). Parimet, se norma specifike ka përparësi nga norma e përgjithshme (*lex specialis derogat generali*) dhe se norma që ka hyrë në fuqi më vonë ka përparësi nga norma e mëparshme, nuk veprojnë në raste të tilla".

12. Referuar këtij rregulli vendimi kuptohet qartazi, që në interpretimin e normave juridike, çdo organ duhet që fillimisht të analizojë nëse ato kanë fuqi të njëjtë juridike apo jo. Në rastin konkret, rezultojnë se ligji nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", si edhe ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" i ndryshuar, referuar preambulës së tyre, janë miratuar bazuar në parashikimin e nenit 81, pika 2 të Kushtetutës, pra janë ligje me shumicë të cilësuar dhe për rrjedhojë kanë të njëjtën fuqi juridike.

13. Bazuar në këtë aspekt, Këshilli do të duhej të vlerësonte se cili prej tyre është ligji i posaçëm, analizë e cila mungon në arsyetimin e këtij vendimi. Duke analizuar përmbajtjet e këtyre ligjeve rezultojnë qartazisht se përgjegjësia disiplinore e prokurorëve, rregullohet nga ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" i ndryshuar, nenet 100 – 157 të tij. Pra, është ky ligji specifik që do të duhej të zbatohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe vetëm ky.

14. Duke mos ndjekur këtë linjë arsyetimi, shumica ka dalë jashtë rregullit interesues kryesor, atë që ligji i posaçëm prevalon ndaj ligjit të përgjithshëm (*lex specialis derogat generalis* ose edhe *General/specifik canon*). Në rastin e kësaj çështjeje, neni 189 i ligjit nr. 115/2016 i ndryshuar, përfaqëson një rregull të përgjithshëm mbështetës, që referon te Kodi i Procedurave Administrative vetëm nëse nuk ka rregullime të posaçme. Por pezullimi i procedurës disiplinore është rregulluar shprehimisht në mënyrë të detajuar nga ligji nr. 96/2016 i ndryshuar, i cili parashtrohet rrethana të qarta, dhe të mirëpërcaktuara, për pezullimin e hetimit apo të procedimit disiplinor. Ligji i posaçëm ka vendosur, në mënyrë taksative, që vendimi për pezullim merret vetëm nëse përmbushen kriteret që ka përshkruar, dhe se vendimi nuk është i ankueshëm. Për rrjedhojë, mund të konkludohet Këshilli, nuk ka pasur jo vetëm nevojën, por as të drejtën ligjore për të aplikuar Kodin e Procedurave Administrative në këtë rast.

15. Në vijim më tej, shumica i referohet parashikimeve të neneve 126 dhe 145 të ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve*" i ndryshuar, por duke i vendosur të dytat në linjën e saj arsyetuese, tregon se i përdor si argumente mbështetëse ndaj parashikimit të Kodit të Procedurave Administrative, që siç e shpjegojmë më sipër, nuk është legjislacion i zbatueshëm në këtë çështje.

16. Nëse i referohemi këtyre dy dispozitave, rezulton se neni 145 i ligjit, titulluar "*Pezullimi i procedimit disiplinor*", përcakton se: "*Parashikimet ligjore gjatë procedimit disiplinor të nenit 126, të këtij ligji, do të aplikohen për atë që gjejmë zbatim*". Pra, ky parashikim që i jep të drejtë Këshillit të pezullojë procedimin disiplinor, është një normë që të referon në nenin 126 të po të njëjtit ligji, i cili i titulluar "*Pezullimi i hetimeve*", parashikon se: "*1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil: a) në të cilat, njëra nga palët është magjistrati; b) shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi*".

17. Nëse analizojmë këto dy raste mund të arrihet në konkluzion se mund të vendoset pezullimi i hetimit disiplinor kur është duke u zhvilluar hetim penal ose një proces gjyqësor penal, administrativ ose civil nëse plotësohen dy kushte, ku *së pari* njëra nga palët në këto procese është magjistrati, që po hetohet disiplinarisht dhe *së dyti* shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte, për të cilat do të merret vendimi.

18. Struktura gramatikore dhe logjike e kësaj dispozite kërkon që të jenë të pranishme të dyja kushtet njëkohësisht. Vetëm kështu mund të realizohet qëllimi i pezullimit si instrument për të shmangur konflikte faktike ose juridike ndërmjet proceseve paralele, dhe për të ruajtur integritetin e procedurës.

19. Këto dy kushte nuk mund të trajtohen si rrethana alternative, pasi secila prej tyre, e marrë veçmas, nuk përmbush qëllimin e plotë të pezullimit. Qëllimi i ligjvënësit nuk është thjesht të pezullojë një hetim disiplinor për shkak të ekzistencës së një procesi tjetër gjyqësor ku prokurori është palë, por të shmangë rrezikun e vendimmarrjes së parakohshme apo të vendimeve të ndryshme, por në konflikt me njëri – tjetrin dhe që mbështeten mbi të njëjtën bazë faktike.



20. Nëse do të mjaftonte vetëm kushti i parë, që magjistrati është palë në një proces tjetër, pezullimi, si institut, do të mund të përdorej si një instrument formal për shtyrjen apo bllokimin e hetimit disiplinor, edhe kur fakti që shqyrtohet nuk ka lidhje me atë proces. Nga ana tjetër, nëse do të merrej si i mjaftueshëm vetëm fakti që shkelja ka lidhje me të njëjtat rrethana, por magjistrati nuk është palë në atë proces, atëherë do të mungonte elementi i rrezikut të konfliktit procedural apo të shkeljes së të drejtës së mbrojtjes, që është thelbësor për pezullimin.

21. Vetëm bashkimi i të dyja kriterëve, pra, që prokurori është palë në një proces tjetër dhe që procesi ka të njëjtën bazë faktike me hetimin disiplinor, justifikon *ndërprerjen e përkohshme* të hetimit, pasi vetëm në këtë konfigurim ekziston rreziku i cenimit të parimit të “*non bis in idem*”, i konfliktit midis vendimeve të ndryshme apo i ndikimit të një procesi në thelbin e një procesi tjetër.

22. Për pasojë, formulimi ligjor që kërkon përmbushjen e këtyre dy kushteve njëkohësisht, nuk është i rastësishëm, por ndërton një standard të dyfishtë garantues, i cili kërkon ekzistencën kumulative të të dyja kushteve, duke i shërbyer balancës ndërmjet të drejtës për mbrojtje të magjistratit dhe interesit publik për ndjekjen e shpejtë dhe efektive të përgjegjësisë së tij disiplinore.

23. Në rastin konkret, këto dy kushte nuk plotësohet, pasi për prokurorin Elio Mazreku rezultojnë që me vendimin nr.717, datë 23.11.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është vendosur “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Elio Mazreku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*”. Ky dispozitiv nuk mundet që të kuptohet i shkëputur nga pjesa arsyetuese e tij, nga ku rezultojnë që ky prokuror të jetë vlerësuar për të treja kriteret: atë të pasurisë, figurës dhe anës profesionale.

24. Nga arsyetimi i KPK-së rezultojnë se, për kriterin e pasurisë është konkluduar se: “*43.1.8 Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur për periudhën 1995 – 2003 dhe për vitet 2004 – 2016, nga ku duket se periudha 1995 – 2003, vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014 paraqiten me balancë negative fondesh në vlera të konsiderueshme. Totali i balancës negative të fondeve është në shumën prej rreth 22.8 milionë lekësh.*

25. ...

26. *43.2 Si konkluzion, referuar kësaj analize, rezultojnë një balancë negative fondesh në total për vlerën prej rreth 20.6 milionë lekësh, nga ku Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen/mbulimin e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1995 – 2003 dhe për vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.*



27. *Konkluzioni i Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë*

44. *Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; (ii) ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë, duke u vendosur në kushtet parashikuara sipas leximit acontrario të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e këtij ligji, çka përbën shkak për shkarkimin e tij nga detyra në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016”.*

28. Përsa i përket kriterit të dytë, “kontrolli i figurës”, KPK-ja ka konkluduar se: “54. Sa më sipër, nga analizimi në tërësi i shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ, Komisioni arrin në përfundimin se për subjektin e rivlerësimit, z. Elio Mazreku, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës”.

29. Për kriterin e tretë, “vlerësimi i aftësive profesionale”, KPK-ja ka konkluduar se: “68. Si përfundim, nga vlerësimi tërësor i gjetjeve të evidentuara në trajtimin e kriterit të vlerësimit profesional, në raport me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti nëpërmjet prapësimeve të depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe sqarimet e dhëna prej tij në seancë dëgjimore, Komisioni vlerëson se ato nuk përbëjnë shkelje procedurale të tilla, që mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

30. Nga, këto të dhëna rezultojnë qartësisht se prokurori Elio Mazreku është shkarkuar vetëm për kriterin e parë, atë të pasurisë ndërsa për dy kriteret e tjera, ku përfshihet edhe ai profesional, nuk janë konstatuar problematika.

31. Nga të dhënat e publikuara rezultojnë gjithashtu se Komisioneri Publik, nuk ka ushtruar ankim ndaj këtij vendimi të KPK-së (<https://ikp.al/wp-content/uploads/2024/01/Njoftim-p%C3%ABr-mosankimin-e-vendimit-nr.-717-dat%C3%AB-23.11.2023-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%ABr-subjektin-e-rivler%C3%ABSimit-z.-Elio-Mazreku.pdf>).

32. Nga të dhënat e publikuara nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, (<https://kpa.al/juridiksion-rivleresimi-2024/>), rezultojnë për këtë proces është publikuar njoftimi vijues:

- i.Emërtimi:* Ankim kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 717 vendimi, datë 23.11.2023
- ii.Data e regjistrimit:* 07.02.2024
- iii.Vënë në lëvizje nga:* Subjekti i rivlerësimit



iv. **Objekti:** Gjykimi i çështjes në seancë gjyqësore publike.

v. **Ndryshimi i vendimit nr. 717, datë 23.11.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur konfirmimin tim në detyrë.**

vi. **Përbërja e trupit gjykues:**

vii. **Kryesuese:** Natasha Mulaj

viii. **Relatore:** Albana Shtylla

ix. **Anëtarë:** Sokol Çomo, Rezarta Schuetz, Mimoza Tasi

x. **Statusi:** Përgatitje për gjykim

33. Nga sa më sipër, rezulton qartësisht se për kriterin profesional, procesi i rivlerësimit kalimtar është përmbyllur me vendim të formës së prerë dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit, i vënë në lëvizje vetëm nga ana e prokurorit, subjekt i këtij procesi, do të analizojë dhe shprehet vetëm për kriterin e pasurisë.

34. Ndërkohë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nuk e ka sjellë kërkesën për procedim për shkak se ka bërë verifikimin e pasurisë dhe figurës sipas nenit 124/1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar, por ky procedimin është sjellë për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, germa “ç”, “d”, “ë” dhe “g” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar, pasi janë konstatuar disa raste tejkalimi të afateve tërësore të hetimit, afateve të parashkrimit të ndjekjes penale dhe zvarritje të pajustificuara të hetimeve.

35. Bazuar në këto të dhëna, për këto dy çështje, si edhe në parashikimet e nenit 126 të ligjit nr. 96/2016 Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar, rezulton se në rastin e zotit Elio Mazrekut, analiza faktike tregon qartazi se asnjë nga këto dy kushte nuk plotësohet.

36. Kështu, procedimi disiplinor ndaj këtij prokurori është iniciuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për shkelje profesionale dhe procedurale, të tilla si: tejkalimi i afateve të hetimit, mosrespektimi i afateve të parashkrimit dhe zvarritja e pajustificuar e çështjeve penale. Këto shkelje janë të natyrës menaxheriale dhe procedurale, që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij si prokuror në trajtimin konkret të çështjeve penale. Ndërkohë, procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit ka për objekt vetëm kriterin e pasurisë dhe është iniciuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, si reagim ndaj vendimit të KPK-së që e shkarkoi nga detyra.

37. Nga analiza e vendimit nr. 717, datë 23.11.2023, të KPK-së dhe të dhënave publike nga KPA, rezulton se trupi gjykues nuk do të shqyrtojë çështje që lidhen me kriterin profesional, për të cilin KPK-ja ka dhënë vlerësim pozitiv dhe ndaj të cilit nuk ka pasur ankim nga Komisioneri Publik. Për pasojë, nuk ekziston asnjë proces gjyqësor paralel ku të shqyrtohen ato veprime konkrete profesionale që janë objekt i procedimit disiplinor nga ILD.

38. Edhe pse ky prokuror është palë në një proces gjyqësor në KPA, ky proces nuk ka asnjë lidhje me shkeljet e pretenduara nga ILD. Procesi në KPA është një proces kushtetues i rivlerësimit, që nuk shqyrton përgjegjësinë disiplinore ose profesionale, por vetëm pajtueshmërinë



e subjektit me standardet e *vetting*-ut. Për më tepër, nuk ka asnjë të dhënë që ndonjë nga faktet e hetuara nga ILD të jenë objekt shqyrtimi apo prova në procesin para KPA-së. Kështu, kërkesa për pezullim bie ndesh me logjikën e nenit 126, pasi rreziku i konfliktit faktik ose ndikimit reciprok mes proceseve thjesht nuk ekziston.

39. Dispozita e nenit 126 është ndërtuar për të shmangur dy vendimmarrje paralele mbi të njëjtat fakte, duke mbrojtur parimin "*non bis in idem*", integritetin e provave dhe të drejtën e subjektit për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën sjellje. Në këtë rast, ky rrezik nuk është real dhe as hipotetik: vendimi i KPK-së ka përfunduar mbi të tre kriteret, me shkarkim vetëm për kriterin e pasurisë; KPA do të shqyrtojë vetëm këtë aspekt, dhe në asnjë mënyrë nuk ka gjasa që vendimmarrja e KPA-së të përplasë me atë të KLP-së ose ILD-së për çështje të disiplinës profesionale. Në të vërtetë, shkarkimi për pasurinë as nuk ndihmon, as nuk pengon vlerësimin e shkeljeve që lidhen me performancën si prokuror.

40. Lejimi i pezullimit në mungesë të lidhjes faktike mes proceseve do të transformonte dispozitën e nenit 126 në një instrument formal për të vonuar ose bllokuar hetimet disiplinore, pa ndonjë shkak të ligjshëm. Vetë natyra e dispozitës është mbrojtëse, jo favorizuese. Zgjerimi i paarsyeshëm i kësaj norme do të sillte pasoja të kundërta me qëllimin për të garantuar një sistem disiplinor efektiv, të drejtë dhe të zbatueshëm në kohë.

41. *Shumica* në vendimmarrjen e saj e shmang totalisht analizën e mësipërme,. Kjo shmangie, përveç faktit që tregon pabazueshmërinë e qëndrimit të shumicës së Këshillit tregon edhe që vendimi i shumicës mbetet i paarsyetuar në kuptim të nenit 100 të Kodit të Procedurave Administrative.

42. Përmendja më pas e parashikime të normave kushtetuese dhe ligjore që kanë të bëjnë me procesin e rivlerësimit kalimtar, dukshëm nuk qëndrojnë. Kështu,  *shumica* në arsyetimin e saj bazohet edhe në nenin 179/b, pika 7, të Kushtetutës, që parashikon se: "*7. Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë...*" Siç mund të konstatohet me lehtësi, ky parashikim kushtetues, përdor ndajfoljen "**krahas**", të cilin  *shumica* nuk tenton aspak që ta arsyetojë.

43. Duke qenë se nuk kemi asnjë përkufizim, për këtë situatë, atëherë në këtë rast do të duhet që të zbatohet rregulli interpretues i kuptimit të zakonshëm të termave (*ordinary meaning canon*), për të cilin do të duhet që t'i referohemi, për një qasje sa më objektive, Fjalorit të Gjuhës Shqipe të vitit 2006, i cili për këtë ndajfolje na jep këtë përkufizim "**krahas ndajf. 1. për krahësh; në krah; përbri: u kapën krahas; ecnin (rrinin) krahas. 2. në të njëjtën kohë; baras; njëllor: u shqyrtuan krahas. • parafj. (r. rr.) 1. përbri dikujt a diçkaje: rrinte krahas mësueses. 2. bashkë ose në të njëjtën kohë me dikë a me diçka: krahas mësimeve, bënte edhe sport**".

44. Siç rezulton nga ky përkufizim gjuhësor, i kësaj ndajfoljeje, del qartësisht kuptimi i nenit 179/b, pika 7 të Kushtetutës, sipas të cilit masat që merren në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, shqyrtohen në të njëjtën kohë me shkaqet dhe procedurat e tjera që parashikon Kushtetuta



dhe ligji nr. 96/2016 *Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve*” i ndryshuar, për procedimin disiplinor.

45. Nga sa më sipër qartazi rezulton se arsyetimi i *shumicës* së Këshillit për pezullimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit Elio Mazreku nuk qëndron, për shkak se bazohet në një tejkalim artificiale dhe jashtë kuadrit ligjor të dispozitave që rregullojnë raportin ndërmjet procesit të rivlerësimit kalimtar dhe procedimit disiplinor. Pretendimi se ekziston një çështje paraprake, e cila përbën parakusht për shqyrtimin e procedimit disiplinor, nuk gjen mbështetje në strukturën dhe natyrën juridike të këtyre dy proceseve, të cilat, edhe pse zhvillohen ndaj të njëjtit subjekt, janë të ndara, të pavarura dhe të bazuara mbi standarde, procedura dhe qëllime krejtësisht të ndryshme.

46. Gjithashtu, procesi i rivlerësimit kalimtar, i parashikuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”*, nuk ka si objekt verifikimin e përgjegjësisë për shkelje konkrete të natyrës funksionale apo procedurale të magjistratit në ushtrimin e detyrës, por vetëm kontrollin e ligjshmërisë së pasurisë, të pastërtisë së figurës dhe të aftësive minimale profesionale. Në rastin konkret, siç e përmendëm dhe më sipër, shkarkimi i zotit Elio Mazrekut nga KPK-ja është vendosur vetëm për kriterin e pasurisë, ndërkohë që për kriterin profesional është dhënë një vlerësim pozitiv dhe kjo çështje nuk është më objekt shqyrtimi përpara Kolegji të Posaçëm të Apelimit. Prandaj, pretendimi se vendimi përfundimtar i KPA-së për pasurinë do të ndikojë në shqyrtimin e procedimit disiplinor për shkelje të natyrës profesionale është i pabazuar, pasi **objektet janë krejtësisht të ndryshme** dhe nuk kanë lidhje faktike apo juridike midis tyre.

47. Nga nga ana tjetër, edhe pse ligji për rivlerësimin përdor terminologji të ngjashme, procesi i *vetting*-ut nuk zhvillohet në bazë të një kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për shkelje të veçanta, por në kuadër të një **procesi të jashtëzakonshëm, të përgjithshëm dhe të detyrueshëm**, pa natyrë “akuzuese”. Për këtë arsye, përfundimi i këtij procesi nuk përbën asnjë pengesë për zhvillimin paralel të një procedimi disiplinor, për aq kohë sa ai mbështetet në fakte të tjera, që nuk janë shqyrtuar apo vlerësuar nga KPK apo KPA.

48. Përsa i përket interpretimit të *shumicës* që e barazon statusin “i pezulluar nga detyra” me pamundësinë për t’u proceduar disiplinarisht, kjo qasje është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 96/2016 *Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve*” i ndryshuar, i cili nuk e ndalon zhvillimin e një procedimi disiplinor ndaj një magjistrati të pezulluar, përkundrazi, parashikon që ai të vijojë, dhe vetëm nëse verifikohet mbarimi i statusit, të çojë në mbylljen e procedimit pa një vendim përfundimtar. Pra, mbarimi i statusit është kushti për mbylljen e procedurës, jo pezullimi i tij.

49. Më tej, referimi që *shumica* i bën nenit 66 të Kodit të Procedurave Administrative, si bazë për pezullimin, është i pasaktë në këtë kontekst. Kjo dispozitë aplikohet për raste kur një vendimarrje administrative është realisht e varur nga rezultati i një çështjeje tjetër të pavarur dhe që ka lidhje të drejtpërdrejtë faktike ose juridike me çështjen kryesore. Në këtë rast, vendimi i



pritishtëm i KPA-së nuk do të trajtojë asnjë nga faktet që janë objekt i procedimit disiplinor të nisur nga ILD, dhe për rrjedhojë nuk mund të cilësohet si çështje paraprake. Në mungesë të lidhjes faktike, pretendimi për pezullim bie poshtë edhe sipas vetë standardeve të Kodit të Procedurave Administrative, i cili nuk lejon zgjatimin analog të rrethanave që e justifikojnë pezullimin.

50. Në të njëjtën mënyrë, argumenti se ekzistenca e një vendimi për shkarkim në proces verifikimi nga KPA sjell si efekt ligjor detyrimin për të pezulluar një procedim tjetër është i pajustificuar. Përkundrazi, një qasje e tillë i hap rrugë bllokimit të procedimeve disiplinore për një kohë të pacaktuar, duke minuar qëllimin e ligjit për ndëshkimin e sjelljeve konkrete të papërshtatshme apo të dëmshme për funksionin, dhe duke i hequr peshë vetë mekanizmit të përgjegjësisë disiplinore. Legjislacioni kërkon që proceset disiplinore të jenë efektive dhe të zhvillohen pa vonesa të pajustificuara, ndërkohë që pezullimi, në këtë rast, mbështetet në një justifikim procedural që nuk ka as bazë faktike, as bazë ligjore.

51. Përsa i përket dispozitës tjetër që citohet nga shumica dhe konkretisht neni 164 i ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve*" i ndryshuar, që parashikon se magjistratët gëzojnë statusin e tillë vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, nuk mund të interpretohet si një bazë për pezullimin e një procedimi disiplinor, për aq kohë sa ajo nuk lidhet aspak me natyrën apo objektin e përgjegjësisë disiplinore të magjistratit. Ky nen i referohet qartësisht dhe vetëm procesit të rivlerësimit kalimtar, që ka si qëllim kontrollin e kritereve themelore të integritetit (pasurisë, figurës dhe aftësive minimale profesionale) për të garantuar përshtatshmërinë e magjistratit për të vijuar funksionin, dhe jo vlerësimit të veprimeve konkrete, sjelljes profesionale, apo shkeljeve të detyrës që përbëjnë objektin e procedurës disiplinore.

52. Interpretimi që i jepet kësaj dispozite nga shumica, që e përdor si justifikim për të ndërprerë ose pezulluar një procedim disiplinor në pritje të përfundimit të procesit të rivlerësimit, nuk qëndron, sepse e shtrin përtej fushës së saj të zbatimit. Në të vërtetë, ligji flet për kushtin për të mbajtur statusin, pra për të qenë magjistrat në mënyrë të vazhdueshme, jo për pezullimin ose ndërprerjen e mekanizmave të brendshëm të përgjegjësisë për shkelje të disiplinës gjatë kohës kur statusi është ende në fuqi. Vetë fakti që një magjistrat ndodhet në proces rivlerësimi nuk e përjashton nga përgjegjësia për sjelljen e tij si prokuror dhe, aq më pak, e mbron nga vlerësimi disiplinor i veprimeve të tij.

53. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në ushtrimin e kompetencave të tij, është i detyruar të respektojë kuptimin e qartë dhe të drejtpërdrejtë të fjalëve të ligjit, pa devijuar në interpretime të tejzgjatura që shkojnë përtej synimit të ligjvënësit. Neni 164 nuk parashikon, as në mënyrë të shprehur, as të nënkuptuar, që nisja apo zhvillimi i një procesi të rivlerësimit pezullon apo ndalon ushtrimin e përgjegjësisë disiplinore nga Këshilli për sjellje që lidhen me funksionin. Përkundrazi, ligji i ndan qartësisht këto dy fusha, ku procesi i rivlerësimit është një mekanizëm njëherësh dhe i përgjithshëm, ndërsa procedimi disiplinor është i rastësishëm dhe i veçantë, që aktivizohet në prani të fakteve konkrete dhe me pasoja specifike për veprimtarinë institucionale dhe etike të magjistratit.

54. Të pranohet që neni 164 ka efekt pezullues për një procedim disiplinor do të thotë t'i jepet këtij neni një funksion që ai nuk e ka dhe nuk e synon ta ketë. Do të thotë gjithashtu të përjashtohet një magjistrat, përkohësisht, nga vlerësimi i veprimit të tij si funksionar publik, thjesht sepse ai ndodhet nën kontrollin e një tjetër organi që vlerëson kriteret e integritetit, por jo sjelljen profesionale në raport me standardet disiplinore. Kjo do të përbënte një keqpërdorim të konceptit të "mbarimit të statusit" dhe një shmangie nga logjika e ligjit, që synon përgjegjshmëri të vazhdueshme për aq kohë sa statusi nuk ka marrë fund.

55. Në këtë mënyrë, çdo përpjekje për të justifikuar pezullimin e një procedimi disiplinor mbi bazën e nenit 164 përfaqëson një shkelje të qasjes tekstuale dhe sistematike ndaj interpretimit ligjor, si dhe një tendencë për të zhvendosur përmbajtjen dhe qëllimin e dispozitës përtej kufijve të saj të natyrshëm. Këshilli *nuk mund* dhe *nuk duhet* të dalë nga kuptimi i drejtpërdrejtë i ligjit për të mbështetur vendime që, në të vërtetë, çojnë në pasivizimin e sistemit të përgjegjësisë dhe cenojnë besueshmërinë e publikut në funksionimin e institucioneve të drejtësisë.

56. Gjithashtu, përmendja apo ndjekja e vendimmarrjeve të mëparshme të Këshillit, nuk mund të mbizotërojë ndaj ligjit. Rregullat e vendosura nga ligjvënësi dhe të interpretuara në mënyrë të saktë kanë përparësi absolute ndaj praktikës së brendshme, e cila në vetvete mund të jetë e jo e drejtë. Prandaj, ruajtja e praktikës së mëparshme nuk mund të bëhet në dëm të saktësisë juridike dhe të detyrimit për të zbatuar drejt ligjin në fuqi, në mënyrë të drejtpërdrejtë.

57. Për të gjitha këto arsye, arsyetimi i *shumicës* për vendosjen e pezullimit të procedimit disiplinor ndaj Elio Mazrekut nuk qëndron. Shumica ngatërron natyrën e proceseve, zgjat pa të drejtë fushën e zbatimit të normave që rregullojnë çështjet paraprake dhe, në thelb, vë në rrezik funksionimin efektiv të sistemit të përgjegjësisë disiplinore të magjistratëve.

58. Përsa më sipër, duke qenë se procedimi disiplinor nuk bazohet në tekstin e normave kushtetuese dhe ligjore, në rregullat e interpretimit, në parashikimet gjuhësore si edhe në ndonjë jurisprudencë të mirëfilltë gjyqësore. Kjo, si *Anëtarë në pakicë* na çon në konkluzionin se shumica nuk ka zbatuar normat kushtetuese dhe ligjore siç janë, por si ato do të kishin dashur që të ishin.

59. Për këtë arsye, nuk mundet që të pajtohemi me qëndrimin e *shumicës* dhe e kundërshtojmë atë.

Anëtar/relator  
Vatë Staka

Kryetare  
Mirela Bogdan

Anëtar  
Erind Merkuri